



Qarku Berat

Pushteti Vendor & Shoqëria Civile

...një aleancë në zhvillim

Intervistë me Zv/Kryetarin e Qarkut Berat – Z. Petrit Sinaj

Si mendoni, a ka bërë mjaftueshëm pushteti vendor për të nxitur/përfshirë në partneritet aktorë të shoqërisë civile? Po me biznesin?

Mendoj se niveli në të cilin ndodhet bashkëpunimi është ende i pa-arrirë. Faktorët që ndikojnë në këtë nivel janë të ndryshëm por, më kryesorët do të përmendja: mungesa e strategjive lokale dhe mekanizmave përkatës për përfshirjen sa më të gjerë të shoqërisë civile dhe biznesit në probleme dhe projekte që kanë të bëjnë me komunitetin. OJF-të e rajonit të Beratit për shkak të mungesës së fondeve dhe distancës fizike nga donatorët kryesorë, nuk kanë arritur të fuqizohen dhe të përfaqësojnë apo të prezantohen fuqishëm në sytë e komunitetit dhe pushtetit lokal. Kjo ka ndikuar në një lidhje të dobët mes pushtetit vendor-OJF-komunitet. E njëjta situatë shfaqet edhe për biznesin lokal i cili, me përjashtim të disa rasteve, kryesisht ka humbur deri diku interesin për t'u përfshirë në iniciativa lokale me karakter humanitar e social.

A përfshihen interesat e shoqërisë civile të zonës suaj në planet e pushtetit vendor?

Aktualisht edhe ato pak organizata që funksionojnë janë të pastrukturuara, me staf të lëvizshëm e shpesh të patajnuara dhe nuk përfaqësojnë gjithë problematikën e grupeve të margji-

nalizuara. Nga ana tjetër edhe pushteti lokal nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur nevojave të komunitetit për t'u organizuar në OJF me qëllim prezantimin dhe zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet dhe që janë përgjegjësi e pushtetit vendor. Zakonisht OJF-të janë përfshirë në pushtetin lokal në rast të zbatimit të projekteve të ndryshme, ose kur ka qenë kërkesë e donatorit.

Me strategjinë e re që po

“Partneriteti me shoqërinë civile dhe grupet e interesit në zonat rurale mundëson përdorim më të madh burimesh dhe eksperiencash, ndihmon në ndërtimin e konsensusit, forcon demokracinë në terma afatgjatë, ndihmon në formimin e urave të besimit dhe konfidencës ndërmjet autoriteteve vendore dhe komunitetit...”

hartohet në bashkëpunim me PNUD-in, është paraparë një rol më i madh i shoqërisë civile, biznesit, grupeve të interesit dhe përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme.

Cili do të ishte për ju një model për nxitjen e tri-partitetit: pushteti vendor – shoqëri civile - biznesi ?

Një bashkëpunim i suksesshëm në tri-partitet në qarkun e Beratit, ka

qenë projekti i Qendrës Ditore në Mbështetje të Integritetit të Moshës së Tretë dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së tyre; projekt i zbatuar nga dega e Kryqit të Kuq Berat, me mbështetjen e pushtetit lokal. Aktivitete të tjera që mund të çojnë në thellimin e bashkëpunimit midis palëve mund jenë gjithashtu organizimi i një forumi vjetor ku të përfshihen OJF-të, pushteti vendor, biznesi dhe komuniteti etj. Një tjetër instrument mund të jetë hartimi i një strategjie bashkëpunimi, për çështje specifike si psh: mbështetja për të pastrehët, promovimi i turizmit, mbështetja e komunitetit rom, integrimi i moshës së tretë etj.

Brenda këtyre partnershipeve tri-palëshe, cili është roli specifik për pushtetin vendor?

Evidentimi i nevojave të komunitetit dhe jo thjesht e një organizate të caktuar, përcaktimi i prioriteteve të zhvillimit dhe bashkëveprimit midis palëve, planifikimi i buxhetit përkatës për financimin e shërbimeve që lidhen me këto nevoja. Gjithashtu zgjedhja dhe përfshirja e OJF-ve dhe e biznesit lokal në këtë partnership, është përgjegjësi e pushtetit vendor, duke krijuar kushte për një bashkëpunim të favorshëm, të besueshëm dhe me rezultate konkrete në të mirë të komunitetit.



Forum Ndërkombëtar: 23 – 24 mars 2012, Dibër

Ndërtimi i urave të bashkëpunimit ndërkufitar




Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Shoqata Ekologjike “Deshat” dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), gjatë datave 23 dhe 24 Marsit - 2012,

organizuan në Shtëpinë e Kulturës në Dibër, Forumin e Shoqërisë Civile nga rajoni ndërkufitar i Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i këtij aktiviteti është të rritet informimi për bashkëpunimin e ndërsjellë të organizatave qytetare nga rajoni ndërkufitar. Rezultatet e pritura janë:

- Informimi për aktivitetet e organizatave qytetare nga rajoni ndërkufitar;
- Komunikimi dhe bashkëpunimi më i mirë i organizatave qytetare;
- Njohja me trashëgiminë kulturore dhe natyrore të rajonit ndërkufitar, si edhe për begatimin e njohjes së ndërsjellë.

Donatorët & Shoqëria Civile: “Të humbur në përkthim...”

Një hartë e plotë e donatorëve në vendet e Ballkanit Perëndimor është realizuar nga Rrjeti i Zhvillimit të Organizatave të Shoqërisë Civile (BSCDN) me



qendër në Shkup, së bashku me informacion dhe burime të nevojshme për të analizuar situatën e zhvillimit të shoqërisë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshi edhe Shqipërinë. Harta paraqet një qasje strategjike ndaj organizatave donatore më aktive në Shqipëri, duke u fokusuar mbi situatën aktuale të financimit të projekteve të ndryshme në zonat rurale dhe urbane të Shqipërisë. Ky studim është realizuar në bashkëpunim me Universitetin Queen Mary me qendër në Londër. Monitorimi do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2012, ku qëllimi është fokusimi



në analizën specifike të vendeve të Ballkanit perëndimor nëpërmjet mbledhjes së të dhënave në terren. Sëbashku me hartën e donatorëve, BSCDN-ja ofron dhe një analizë të titulluar “Strategjitë dhe Praktikët e Donatorëve në Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkan – Shoqëria Civile e Humbur në Përkthim” ku paraqiten konkluzionet e këtij studimi.

Programi i Zhvillimit Rajonal: Shkodër - Lezhë

Bazuar në principet e Deklaratës së Parisit mbi efektivitetin dhe harmonizimin e donacioneve dhe mbështetjes të shoqërisë civile, Austria dhe Zvicra kanë nisur realizimin e një programi në fushën e zhvillimit rajonal dhe decentralizimin në zonat veriore të Shqipërisë.

Decentralizimi dhe zhvillimi rajonal vazhdojnë të mbeten sfidat kryesore për të arritur një zhvillim social – ekonomik të balancuar. Rajonet e Lezhës dhe të Shkodrës, banohen nga

rreth 575 mijë banorë dhe janë ndër më të varfërat në vend, duke vuajtur papunësi të lartë dhe një infrastrukturë të dobët. Megjithatë potenciali dhe burimet e këtij rajoni mund të shfrytëzohen për një zhvillim social ekonomik të qëndrueshëm. Pikërisht ky projekt synon të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm dhe barazi social në rajonet e Lezhës dhe Shkodrës. Objektiv kryesor i këtij programi është të mundësojë akses të barabartë të shërbimeve dhe mundësive ekonomike

për banorët e qarkut të Lezhës dhe Shkodrës. Në këtë kuadër nevojitet një kornizë e decentralizimit, e cila synon zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, rritjen e kapaciteteve institucionale të qarqeve përkatëse mbi zhvillimin e planifikuar si dhe planifikimi i qëndrueshëm i buxhetimit në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës. Ky projekt i cili ka nisur vitin e kaluar do të zgjasë deri në fund të vitit 2014 dhe synon përmirësimin e qeverisjes vendore në rajonin e Lezhës dhe Shkodrës.



THIRREJE PER APLIKIME ! Panairi i Ideve Gjirokastrë, Berat, Lezhë, Elbasan

Panairi i ideve shënon fillimin e fazës së dytë të projektit “Forcimin i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike” që përbëhet nga disa aktivitete. Këto kanë si qëllim të adresojnë shqetësimet kryesore të organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale e periferike nëpërmjet tre instrumenteve kryesore: ndërgjegjësimi, advokimit dhe ngritjes së kapaciteteve. Panairi i Ideve është konceptuar si një aktivitet që synon të inkurajojë iniciativa konkrete nga aktorë të shoqërisë civile në këto zona për të promovuar një rol më aktiv të shoqërisë civile dhe një qytetari aktive në të mirë të komunitetit. Në këtë kuadër “Panairi i Ideve” inkurajon iniciativa dhe ide nga organizatat joqeveritare të bazuara ose me fokus kryesor në

zonat rurale e periferike për të adresuar probleme konkrete dhe çështje relevante për komunitetin dhe qeverisjen në këto rajone. Ky konkurs i ideve dhe iniciativave inovative është i hapur për të gjitha organizatat joqeveritare, unione, shoqëri, grupe interesi nga rajoni i Beratit, Lezhës, Elbasanit dhe Gjirokastrës. Pas pranimit të ideve të aktorëve të shoqërisë civile për një periudhë tre javore, një grup ekspertësh do të bëjë vlerësimin e propozimeve të pranuar dhe do të selektojë një total prej 50 iniciativash. Aplikantët e suksesshëm do të ftohen për të prezantuar projektet e tyre në këtë Panair Idesh, që do të zhvillohet në Tiranë, gjatë muajit qershor. Ky aktivitet nuk është projektuar vetëm me qëllim prezantimin e propozimeve, por në të njëjtën kohë për t'i dhënë mundësi organizatave pjesmarrëse të krijojnë kon-

takte e ura bashkëpunimi me njëri-tjetrin si dhe me donatorë të mundshëm.

Ky aktivitet është një iniciativë e re për të nxitur nismat e ardhura nga shoqëria civile në zonat rurale dhe periferike dhe për të mundësuar bashkëpunimin mes aktorëve të ndryshëm drejt një qeverisjeje të mirë gjithëpërfshirëse. Për dokumentet e aplikimit vizitoni faqen tonë: www.idmalbania.org

Tematikat kryesore

- Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi qeverisjen gjithëpërfshirëse dhe promovimi i vullnetarizmit
- Rritja e pjesmarrjes së grave në jetën komunitare e politik-bërje
- Bashkëpunimi më i gjerë dhe krijimi i partnershipeve midis qytetarëve, sektorit privat dhe atij publik
- Adresimi i problemeve sociale, shëndetësore, edukative në veçanti me fokus në grupet vulnerabël / të marxhinalizuara

Workshope Rajonale - Tiranë & Berat

“Shoqëria civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri”

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim do të vazhdojë fazën e tretë të workshopeve rajonale në kuadër të projektit “Fuqizimi i Shoqërisë civile në zonat rurale e periferike” (ECSRA). Workshopen e radhës do të zhvillohen në qytetin e Tiranës dhe Beratit, përkatësisht në datat 11 Qershor dhe 15 Qershor 2012. Në workshop do të

marrin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të pushtetit vendor dhe aktorë të tjerë të angazhuar në zhvillimin dhe avancimin e shoqërisë civile në përgjithësi, e asaj në zonat rurale në veçanti. Qëllimi i këtij aktiviteti është diskutimi i gjetjeve të studimit: “Shoqëria Civile në Zonat Rurale dhe Periferike në Shqipëri”, si dhe konkretizimi

i hapave që duhet të ndërmerren për rivitalizimin dhe riorientimin e shoqërisë civile në këto zona. Pjesa e dytë e workshop-eve është konceptuar për të prezantuar informacion të detajuar mbi procedurat e aplikimit për nisma konkrete nga OJF të interesuara, zbatimi i të cilave në zonat rurale e periferike do të mbështetet nga Projekti ECSRA.



Drejt Partneriteteve Lokale: Qeveri - Biznes - Shoqëri Civile

Përfundon raundi i dytë i trajnimeve mbi rritjen e kapaciteteve dhe rolit të qeverisjes lokale në partneritetet tre-palëshe: shoqëri civile, qeverisje vendore dhe komuniteti i biznesit



Për një qeverisje sa më efektive dhe efektive është e domosdoshme të përmirësohet cilësia e bashkëpunimit midis aktorëve kryesorë në shoqëri. Në këtë kornizë, IDM në kuadër të projektit “Fuqizimi i shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike”, zhvilloi raundin e radhës të trajnimeve, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe rolit të qeverisjes lokale në partneritetet tre-palëshe: shoqëri civile, qeverisje vendore dhe komuniteti i biznesit. Këto trajnime u zhvilluan gjatë muajve Janar - Mars 2012, me përfaqësues të qeverisjes vendore në katër qarqet e përfshira në këtë projekt: Berat, Elbasan, Gjirokastrë dhe Lezhë.

Pjesa e parë e modulit të trajnimit përfshinte konceptet dhe parimet kryesore të një partneriteti tre palësh, kuadrin ligjor dhe politikat për bashkëpunimin e pushtetit vendor, shoqërisë civile dhe sektorit privat. Ndërsa pjesa e dytë e trajnimit u zhvillua në një mënyrë më interaktive, për të reflektuar dhe diskutuar në lidhje me mundësitë, vështirësitë dhe fushat prioritare për të lidhur një partneritet tre-palësh.

Siç u vu re edhe nga ky cikël trajnimesh, ka ende nevojë për të inkurajuar dhe sensibilizuar këta aktorë për rëndësinë e krijimit të partneriteteve për një qeverisje të mirë lokale. Lidhja e partneritetit tre-palësh shihet si një mundësi për të bashkëpunuar për arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Ndërkohë pjesëmarrësit evidentuan disa pengesa në lidhjen e partneritetit që kanë të bëjnë kryesisht me burime të pamjaftueshme financiare, mungesa e një stafi të kualifikuar për të



ndërmarrë partneritete të tilla dhe niveli i lartë i politizimit të vendim-marrjes në nivel lokal.

Në brendësi

Qarku Berat: Pushteti Vendor Vs. Shoqëria Civile	2
Forumi Ndërkombëtar: Ndërtimi i Urave të Bashkëpunimit.....	3
Donatorët dhe Shoqëria Civile: Të humbur në përkthim	3
Programi Zhvillimor Lezhë-Shkodër.....	3
Aktivitete ne Vazhdim.....	4

“Sfidat e Shoqërisë Civile” në një Publikim

Ky raport vlerësues përmbush fazën e parë të projektit – “Studimi për vlerësimin e kapaciteteve të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri”. Duke kombinuar teknikat sasiore me ato cilësore, raporti ofron një panoramë historike të zhvillimit të ShC-së rurale në Shqipëri e rajon, si dhe analizon situatën aktuale në Shqipëri, bazuar në të dhëna sasiore e cilësore të grumbulluara me anë të intervistave të thelluara, pyetësorëve si dhe diskutimeve në grupe për të vlerësuar gjetjet paraprake.



“Menaxhimi i Organizatave të Shoqërisë Civile”

Ky manual synon t'u vijë në ndihmë organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale e periferike si dhe gjithë grupeve të interesuara të qytetarëve dhe aktorëve të tjerë, të cilët kërkojnë të bëhen pjesë e përpjekjeve për të rigjallëruar dhe forcuar më tej rolin dhe ndikimin e sektorit të tretë. Botimi, i ndarë në 6 kapituj kryesorë, trajton çështje të rëndësishme të aktivitetit të shoqërisë civile si: advokimi, menaxhimi financiar, mobilizimi i komunitetit, hartimi dhe zbatimi i projekteve etj.



“Manual mbi bashkëpunimin tre-palësh”

Ky manual përbën një bazë të mirë njohurish mbi zhvillimin e bashkëpunimit mes pushtetit vendor, shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit. Në konceptin e tij më të thjeshtë, partneritetin mund ta kuptojmë si bashkëpunim të ngushtë me një ose disa organizatat të tjera për realizimin e një qëllimi të përbashkët. Në këtë kuadër, “partneriteti” është një instrument i vlefshëm apo “një model organizativ”, për të kapërcyer dobësitë e politikave dhe kuadrin të qeverisjes.

